



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:271768

Datë: 16.01.2024

Numri i dokumentit: 05193618

E.nr.362/2022

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Riza Livoreka dhe bashkëpunëtore profesionale Teuta Bega, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit M. B. , nga Komuna Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokate F. H. nga Ferizaj, kundër debitorit D. K. A. , Komuna Hani i Elezit, rruga “...” nr. 2, për pagesën e diferencës se shtesës mujore ne pagën baze, jashtë seancës gjyqësore, më datë 16.10.202, mori dhe në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën E.nr.362/22, të kreditorit M. B. , nga Hani i Elezit, kundër debitorit K. H. E. -D. K. A. , rruga “Nuri Bushi” nr.2, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

A r s y e t i m

Kreditori me datën 12.12.2022, ne Gjykatën Themelore ne Ferizaj Dega ne Kaçanik e ka dorëzuar propozimin për përmbartim, me të cilin ka kërkuar qe te ekzekutohet Pajtimi Gjyqësor i datës 03.11.2022, i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutohemi, po ashtu me këtë propozim i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbartimore.

Gjykata me datën 20.12.2022, e ka lejuar përmbartimin, sipas propozimit për përmbartim dhe me këtë aktvendim e ka njoftuar debitorin, qe në afate prej 7 ditëve, mundë të paraqes

prapësim. Debitori me datën 21.12.2022, e ka pranuar propozimin për përmbarim me prova dhe në afatin e paraparë ligjorë nuk ka paraqitur prapësim.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin E-nr.362/22 të datës 09.02.2023, e ka urdhëruar Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve -Thesari i Kosovës , qe të bëhet ndalimi i mjeteve nga llogaria e debitori dhe mjetet të barten në llogarinë e të autorizuarës së kreditores, si ne propozimin për përmbarim dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

E autorizuar e kreditorit, me datën 29.05.2023, përmes emalit zyrtar, e ka njoftuar gjykatën se debitori e ka përmbushur detyrimin, sipas marrëveshjes qe palët e kane arritur ne mes veti, është bërë pagesa e shumës së kërkuar në propozimin për përmbarim dhe ka kërkuar qe të përfundohet procedura përmbarimore.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën, e cila konstatohet nga provat ne shkresat e lendes: Marrëveshja mbi pagesën e borxhit, lista e lendeve te ekzekutuara si dhe konfirmimi nga emali zyrtar i datës 29.05.2023.

Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66 par 4, të LPP-së për përfundimin e procedurës përmbarimore. Me këtë dispozitë është paraparë se pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore. Në rastin konkret debitori e ka përmbushë detyrimin gjykata e përfundoi procedurën përmbarimore në këtë çështje përmbarimore.

Nga sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

E-nr.362/22, prej datës 16.01.2024

Gjyqtari
Riza Livoreka

Dërguar me date: 16.01.2024

Kreditorit 1 x 1

Debitorit 1 x 1